

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Practice**

B3

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 07.07.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Një kompani shërbimesh aktualisht po përjeton një zvogëlim të ndjeshëm dhe riorganizim të procesit. Bordi i drejtorëve ka ripërcaktuar qëllimet e biznesit dhe ka krijuar iniciativa duke përdorur teknologjinë e zhvilluar vet për të përmbushur këto qëllime. Si rezultat, është miratuar një qasje më decentralizuese për të drejtuar funksionet e biznesit duke fuqizuar menaxherët e degëve të biznesit për të marrë vendime dhe për të kryer funksione të kryera tradicionalisht në një nivel më të lartë.
- Stafi i auditimit të brendshëm përbëhet nga drejtori, dy menaxherët dhe pesë auditorë-staf, të gjithë me përvojë nga fusha e financave. Në të kaluarën, fokusi kryesor i aktiviteteve të suksesshme të auditimit ka qenë dega e shërbimeve dhe gjashtë selitë rajonale të departamenteve, të cilat mbështesin degët. Këto seli të departamenteve janë objektivat kryesore për eliminimin e mundshëm. Funksionet mbështetëse, siç janë burimet njerëzore, kontabiliteti dhe blerja, do të sjellen në selinë kombëtare dhe teknologjia do të avancohet për të mundësuar dhe shtuar këto operacione.
- Bazuar në ndryshimet e mësipërme dhe duke supozuar se këto burime të përgjithshme të auditimit mbeten të njëjta, cilat aktivitete duhet të kryej departamenti i auditimit të brendshëm për t'i shërbyer më mirë organizatës?
- I. Risë kohën e auditimit në zhvillimin e sistemeve.
 - II. Risë kohën e auditimit në degët e shërbimeve.
 - III. Risë kohën e auditimit në funksionet e centralizuara.
 - IV. Vazhdojë ndarjen e kohës së auditimit njëjtë si më parë.
- A. I dhe II.
B. II dhe III.
C. I dhe III.
D. III dhe IV.
2. Komitetet e auditimit kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në miratimin e:
- A. Promovimit të stafit dhe rritjen e pagave.
 - B. Raportit të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm.
 - C. Orarit të punës së auditimit.
 - D. Emërimin e drejtorit të auditimit të brendshëm.
3. Procesi i rishikimit të kolegëve (peer review) mund të kryhet për brenda ose nga jashtë. Një tipar dallues i rishikimit të jashtëm është qëllimi i tij për të:
- A. Identifikuar detyrat që mund të kryhen më mirë.
 - B. Përcaktuar nëse aktivitetet e auditimit plotësojnë standardet profesionale
 - C. Përcaktuar rekomandimet për përmirësime.
 - D. Dhënë një vlerësim të pavarur.
4. Departamenti i auditimit të brendshëm ka përfunduar një hetim të mashtrimit, i cili zbuloi një ndikim të mëparshëm të pazbuluar, materialisht të pafavorshëm, në pozitën financiare dhe në rezultatet e operacioneve për dy vitet për të cilat janë dhënë tashmë pasqyrat financiare. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet të informojë menjëherë:
- A. Firmën e auditimit të jashtëm përgjegjëse për pasqyrat financiare të prekura nga zbulimi.
 - B. Agjencinë përkatëse qeveritare ose rregullatore.
 - C. Menaxhmentin e duhur dhe komitetin e auditimit të bordit të drejtorëve.
 - D. Funksionin e kontabilitetit të brendshëm të cilë janë përfundimisht përgjegjës për të bërë shënime korigjuese në librat e llogarive.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

5. Cila nga procedurat e mëposhtme të kontrollit do të ishte më pak efektive në parandalimin e një mashtrimi që kryhet duke dërguar urdhër blerje tek furnitorët e rremë?
- A. Kërkoni që të gjitha blerjet të bëhen nga një listë e autorizuar e furnitorëve të mirëmbajtur në mënyrë të pavarur nga individit që vendos urdhrin e blerjes.
 - B. Kërkoni që vetëm furnitorët e aprovuar të paguhen për blerjet, bazuar në prodhimin aktual.
 - C. Kërkoni kontratat me të gjithë furnitorët kryesorë prej të cilëve janë blerë komponentët e prodhimit.
 - D. Kërkoni që blerjet e përgjithshme për një muaj të mos kalojnë shumatat totale të buxhetuara për atë muaj.
6. Departamenti i pranimi të mallit pranon kopjet e urdhër blerjeve të cilat i përdorë për identifikimin dhe regjistrimin e faturave të stoqeve. Në urdhër blerje listohet emri i furnitorit dhe sasi të mallrave të porositura. Një gabim i mundshëm që mund të lejohet ky sistem është:
- A. Pagesat ndaj furnitorëve të paautorizuar.
 - B. Pagesat për blerje të paautorizuara.
 - C. Mbipagesa për dërgesat e pjeshme.
 - D. Vonesa në regjistrimin e blerjeve.
7. Cila nga të mëposhtmet nuk ka gjasa të përfshihet si një hap i auditimit kur vlerësohen politikat e performancës së furnitorit?
- A. Përcaktimi nëse furnitorët dërguan sasi të rëna dakord të .
 - B. Përcaktimi nëse janë pranuar vetëm artikujt e autorizuar nga furnitori.
 - C. Përcaktimi nëse saldoto që i detyroheni furnitorëve janë të sakta.
 - D. Përcaktimi nëse cilësia e mallrave të blera nga furnitorët ka qenë e kënaqshme
8. Zgjidhni popullatën e duhur prej të cilës mund të nxirni mostren, kur objektivi i auditimit është të vlerësojë përpunjen me kontrollet e dizajnuara për të siguruar që të gjitha dërgesat faturohen.
- A. Faturat e paranimuara të klientëve.
 - B. Llogaritë e arkëtueshme të klientëve.
 - C. Dokumentet e paranimuara të dërgesave.
 - D. Të dhënat e pranimi të parasë së gatshme.
9. Identifikoni objektiven e auditimit që mund të realizohet përmes aplikimit të procedurave të auditimit, në vijim, për llogaritë e arkëtueshme tregtare të një firme: (1) përgatitja dhe analizimi i një plani të moshimit të llogarive të arkëtueshme tregtare; (2) diskutimi i të gjitha llogarive potencialisht të dyshimta që janë materiale në vlerë me menaxhmentin. Qëllimi është të përcaktohet nëse:
- A. Llogaritë e arkëtueshme tregtare përfaqësojnë shumatat që ia kanë borxh kompanisë, në datën e bilancit të gjendjes.
 - B. Llogaritë e arkëtueshme tregtare të dhëna si kolateral janë identifikuar dhe shpalosur siç duhet.
 - C. Të gjitha shumatat materiale që ia kanë borxh kompanisë në datën e bilancit, janë regjistruar.
 - D. Lejimet për llogaritë e dyshimta janë të sakta dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare mbahen me shumata neto të arkëtueshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

10. Menaxhmenti i një kompanie prodhuese ka kërkuar nga departamenti i auditimit të brendshëm të kryejë një auditim të sistemit të menaxhimit të parasë për të vlerësuar përshtatshmërinë e kontrolleve ekzistuese të brendshme mbi menaxhimin e keshit dhe për të identifikuar mundësitë për të rritur kontrollin e menaxhimit dhe efikasitetin operativ. Kompania ka katër departamente prodhuese të vendosura në zona të ndryshme gjeografike. Kompania ka deleguar menaxhimin e përditshëm të parave në secilin departament operativ vendor. Paraja e tepërt investohet në programet afatshkurtra të menaxhimit të parasë së gatshme të institucioneve financiare vendase. Këto investime afatshkurtra janë burimi i vetëm i të hyrave nga interesi për departamentet operative. Secili departament ka një linjë kredie me një institucion financiar vendor por duhet të rregullojë nevojat afatgjata të financimit përmes zyrës qendrore të kompanisë.

Gjatë kryerjes së një rishikimi të procedurave të menaxhimit të parasë në departamente për planifikimin paraprak të auditimit, auditori i brendshëm ka vënë në dukje se menaxhmenti është i shqetësuar se:

- Disa departamente kanë saldo të tepërta të parasë dhe mund të mos jenë duke investuar saldot afatshkurtra në mënyrë që të maksimizojnë kthimet në kompani.
- Një departament ka automatizuar procesimin e arkëtimit të parasë së gatshme, por nuk ka implementuar procedurat e duhura të kontrollit për të siguruar që të gjitha paratë do të regjistrohen.
- Procedurat e menaxhimit të parasë së departamenteve mund të mos jenë në përputhje me objektivat e përgjithshme të korporatës (dmth. Mund të mos ketë koordinim të duhur midis zyrës dhe ndarjeve lidhur me menaxhimin e parasë).

Pas hetimit, auditori konstaton se një departament vazhdimisht ka sasi të mëdha të parave të tepërta në kohën kur organizata po merr hua shumë dhe po përdor të ardhurat për të mbështetur departamentet tjera. Procedura më e mirë e kontrollit për të adresuar këtë shqetësim, pa ndonjë ndryshim të madh në procedurat, do të ishte:

- A. Centralizimi i të gjithë procesit të procesimit të parave.
- B. Kërkimi që çdo departament të merret me financimin e vet afatgjatë, duke i detyruar të gjithë që t'i përputhin më mirë nevojat me burimet e tyre të parasë.
- C. Kërkimi që secili departament të përgatisë parashikimet dhe buxhetet e hollësishme të parasë së gatshme për periudhat e ardhshme që do të përdoren për menaxhimin e centralizuar të parasë.
- D. Implementimi i shkëmbimit elektronik të të dhënave me klientët e mëdhenj për të lehtësuar kohën e pranimit të parasë së gatshme.

11. Departamenti i auditimit të brendshëm të një zinxhiri të madh të dyqaneve të pavarura është duke audituar sistemin e blerjes. Një auditori i është caktuar detyra e përcaktimit nëse pajisjet kryesore të zyrës janë duke u blerë me çmimin më të mirë. Auditori duhet të përcaktojë nëse:

- A. Format e urdher blerjeve janë të paranumëruara dhe të kontrolluara.
- B. Kërkesat për blerje nga departamentet përdoruese janë parakushte për blerjen e pajisjeve.
- C. Ofertat konkurruese janë marrë nga furnitorët e aprovuar.
- D. Blerjet e vitit të fundit janë miratuar në buxhetin e aseteve fikse për të njëjtën periudhë.

12. Një auditor i teknologjisë informative (TI) dëgjoi për një të metë në dizajnimin e sistemit aplikativ të bazuar në kompjuter të një projekti të ri zhvillimor. Çfarë duhet të bëjë auditori fillimisht?

- A. Menjëherë të planifikojë auditimin e sistemit të ri.
- B. Mos të bëjë asgjë pasi që është vetëm thashetheme.
- C. Diskutojë çështjen me menaxhmentin e auditimit.
- D. Bisedojë me ekipin e projektit për zhvillimin e sistemit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

13. Një organizatë është rritur me shpejtësi dhe sapo ka automatizuar sistemin e saj të burimeve njerëzore. Organizata ka zhvilluar një bazë të dhënash të madhe që gjurmon punonjësit, përfitimet e punonjësve, zbritjet e pagave, klasifikimet e vendeve të punës, kodin etnik, moshën, sigurimin, mbrojtjen mjekësore dhe informacione të tjera të ngjashme. Menaxhmenti ka kërkuar nga departamenti i auditimit të brendshëm të rishikojë sistemin e ri. Burimet njerëzore dhe pagat janë departamente të veçanta. Cili nga kombinimet e mëposhtme do të siguronte ndarjen më të mirë të detyrave?
- A. Burimet njerëzore shtojnë të punësuarit, orët për pagat dhe ua dorëzojnë punonjësve pagesat.
 - B. Burimet njerëzore shtojnë punonjësit, shqyrtojnë dhe dorëzojnë orët për listën e pagave për procesim dhe dorëzojnë pagat tek punonjësit.
 - C. Burimet njerëzore shtojnë punonjësit dhe orët për paga dhe rgjistrojnë numrat e llogarisë bankare të punonjësve. Pagesat depozitohen automatikisht në llogaritë bankare të punonjësve.
 - D. Departamenti i pagave shton punonjësit dhe fut numrat e llogarive bankare të punonjësve, por proceson orët vetëm sipas miratimit nga burimet njerëzore. Pagesat depozitohen automatikisht në llogaritë bankare të punonjësve.
14. Një kompani shumëkombëshe ka një marrëveshje me një rrjet të vlerës së shtuar (VAN) që siguron kodimin dhe transferimin e komunikimit për këmbimin elektronik të të dhënave të kompanisë (EDI) dhe transferimin elektronik të fondeve (EFT). Para transferimit të të dhënave në rrjetin e vlerës së shtuar, kompania kryen përpunimin paraprak online të transaksioneve. Auditori i brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e kontrolleve të përpunimit paraprak. Përveç kësaj, marrëveshja ndërmjet kompanisë dhe rrjetit të vlerës së shtuar thekson se auditorit të brendshëm i lejohet të kontrolloj dhe raportoj mbi kontrollet ekzistuese (të vendosura) në rrjetin e vlerës së shtuar në baza vjetore. Kontrata specifikon se qasja në rrjetin e vlerës së shtuar mund të ndodhë papritur, gjatë tremujorit të dytë ose të tretë të vitit fiskal të kompanisë. Kjo periudhë është zgjedhur kështu për shkak se nuk do të ndërhynte në përpunimin gjatë periudhave të transaksioneve kulmore të rrjetit të vlerës së shtuar. Kjo dispozitë nuk është shqyrtuar me auditimin e brendshëm. Plani vjetor i auditimit i miratuar nga bordi i drejtorëve specifikon se një auditim i plotë do të bëhet gjatë vitit aktual.
- Cila nga kontrollet në vijim të përpunimit paraprak ka më së paku të ngjarë se do t'i ofroj auditorit siguri në lidhje me vlefshmërinë e transaksioneve?
- A. Verifikimi i kërkuarit.
 - B. Autentifikimi i informacionit.
 - C. Procesimi i përjashtimeve.
 - D. Dekriptimi i të dhënave.
15. Kontrollet e ruajtjes dhe rimëkëmbjes janë thelbësore për të siguruar besueshmërinë e një rrjeti të telekomunikimit. Gjatë shqyrtimit të kontrolleve të ruajtjes dhe rimëkëmbjes, cilat nga të mëposhtmet nuk do të përfshihet?
- A. Rishikimi i përshtatshmërisë së kopjeve të ruajtjes së të dhënave të përdoruesit në rrjetin lokal (LAN).
 - B. Rishikimi i kontrolleve mbi dështimet e harduerit dhe softuerit.
 - C. Rishikimi i përdorimit dhe përshtatshmërisë së proceseve të enkriptimit.
 - D. Rishikimi i përshtatshmërisë së dokumenteve / doracakëve që informojnë të gjithë personelin për përgjegjësitë e tyre për ruajtjen dhe rimëkëmbjen.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

16. Në një qendër kompjuterësh në vende të largët, menaxhmenti ka instaluar një sistem të automatizuar të orareve për të ngarkuar skedarët e të dhënave dhe ekzekutimin e programeve në një kohë të caktuar gjatë ditës. Qasja më e mirë për të verifikuar që sistemi i orareve operon sipas qëllimit është:
- A. Analizimi i aktivitetit të punës me një model të radhës për të përcaktuar karakteristikat e ngarkesës së punës.
 - B. Simulimi i përdorimit të burimeve dhe krahasimi i rezultateve me rezultatet aktuale të operacioneve.
 - C. Përdorimi i softuerit të menaxhimit të bibliotekës për të gjurmuar ndryshimet në versionet e njëpasnjëshme të programeve aplikative.
 - D. Auditimi i të dhënave të punës së kontabilitetit për qasjet në skedarë dhe mesazhet e fillimit / përfundimit të punës.
17. Vendimet e gabuara të menaxhimit mund të jenë rezultat i informacionit jo të plotë. Kontrolli më i mirë për të zbuluar një dështim për të procesuar të gjitha transaksionet e vlefshme është:
- A. Dorëzimi periodik nga përdoruesi i të dhënave testuese.
 - B. Rishikimi nga përdoruesi i outputeve dhe transaksioneve të përzgjedhura të refuzuara nga kontrollet e editimeve.
 - C. Shpërndarja e kontrolluar e outputeve.
 - D. Heqja e outputeve.
18. Një kompani prodhuese blen lloje dhe përmasa të ndryshme të çelikut për përdorim në prodhim. Auditori i brendshëm ka shumë të ngjarë të përdorë një simulim kompjuterik për të vlerësuar funksionin e blerjes së çelikut të kompanisë në lidhje me:
- A. Specifikimet teknike të miratuara për blerjet e çelikut.
 - B. Ekonominë me të cilën kryhet funksioni i magazinimit.
 - C. Efektin e politikave alternative të blerjes për investime në stoqe dhe kostot e mbetjes pa stoqe.
 - D. Cilësinë e programit kompjuterik të përdorur për të përcaktuar sasinë e porosisë ekonomike.
19. Një kompani ka dy objekte prodhuese. Secili objekt ka dy procese prodhuese dhe një proces të veçantë paketimi. Proceset janë të ngjashme në të dy objektet. Lëndët e para të përdorura përfshijnë alumin, materiale për të bërë plastike, kimikate të ndryshme dhe tretës. Ndotja ndodh në disa faza operationale, duke përfshirë dorëzimin dhe ruajtjen e lëndëve të para, përdorimin e kimikateve të procesit, dorëzimin e mallrave të gatshme dhe shitjen. Produktet e mbeturinave të prodhuara gjatë proceseve prodhuese përfshijnë disa që konsiderohen të rrezikshme. Mbeturinat e parrezikshme transportohen në deponinë lokale. Një shitës i jashtëm i mbeturinave përdoret për trajtimin, ruajtjen dhe shitjen e të gjitha mbeturinave të rrezikshme.
- Menaxhmenti është i vetëdijshëm për nevojën për pajtueshmëri me ligjet mjedisore. Kompania kohët e fundit ka zhvilluar një politikë mjedisore që përfshin një deklaratë se secili punonjës është përgjegjës për pajtueshmërinë me ligjet mjedisore.
- Nëse departamentit të auditimit të brendshëm i është dhënë përgjegjësia për kryerjen e një auditimi mjedisor, cili nga veprimet e mëposhtme duhet të kryhet së pari?
- A. Kryerja e vlerësimit të rrezikut për çdo vend.
 - B. Rishikimi i politikave dhe procedurave të kompanisë.
 - C. Sigurimi i trajnimit teknik për personelin e caktuar në këtë detyrë.
 - D. Rishikimi i sistemit të menaxhimit mjedisor.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

20. Firma ligjore e auditimit të një vendi i kërkohet të kryejë auditimin e përputhshmërisë së kompanive që kanë lëshuar kontrata të mbrojtjes në bazë të politikës së çmimeve - kosto plus. Kontratat janë të shkruara në mënyrë të qartë duke përcaktuar kostot e pranueshme, duke përfshirë koston e hulumtimit dhe zhvillimit dhe normat e duhura të kostove të larta.

Gjatë vitit të kaluar, qeveria ka angazhuar në shkallë të gjerë burimet e jashtme për aktivitetet e saj. Burimet e jashtme përfshinin kontrata për të drejtuar kafiteritë, për të ofruar shërbime pastrimi, për të menaxhuar operacionet kompjuterike dhe zhvillimin e sistemeve si dhe për të siguruar inxhinierinë e projekteve të ndërtimit. Kontratat u modeluan duke u bazuar në ato që ishin përdorur për vite në industrinë e mbrojtjes. Auditorët ligjor janë thirrur për të zgjeruar përpjekjet e tyre të auditimit për të përfshirë auditimet e përputhshmërisë së këtyre kontratave.

Pas hetimit fillestar të këtyre fushave të kontraktuara nga jashtë, auditori gjeti shumë fusha në të cilat menaxhmenti i kontraktuar ka zgjeruar me sa duket autoritetin dhe përgjegjësinë e tij. Për shembull, kontraktuesi që menaxhon operacionet kompjuterike ka zhvilluar një program shumë të sofistikuar të sigurisë që mund të përfaqësojë sigurinë më të avancuar të informacionit në industri. Auditori shqyrton kontratën dhe e sheh referencën vetëm për sigurimin e niveleve të përshtatshme të sigurisë informatike. Auditori dyshon se agjencia qeveritare mund të ketë shpenzime zhvillimore që mund të përdorë për avantazh konkurrues në shërbimet e marketingut për organizatat e tjera.

Auditori është i shqetësuar nëse të gjitha debitimet në llogarinë e shpenzimeve të sigurisë kompjuterike janë shpenzimet e duhura. Procedura më e përshtatshme e auditimit do të ishte:

- A. Merrni një mostër të veçorive të faturave kompjuterike dhe përcaktoni nëse të gjitha faturat janë të klasifikuara siç duhet.
- B. Kryeni një rishikim analitik për të krahasuar shumën e shpenzimeve të bëra këtë vit me shumën e shkaktuar në një linjë trendesh për pesë vitet e fundit.
- C. Merrni një mostër të veçorive të shpenzimeve të pagave të punonjësve të shkaktuar nga kompania e kontraktuar nga jashtë dhe gjurmoni klasifikimin e duhur të llogarisë.
- D. Merrni një mostër të të gjitha debive në llogari dhe hetojeni duke shqyrtuar dokumentet burimore për të përcaktuar natyrën dhe autoritetin e shpenzimeve.

21. Punonjësit që përdorin kompjuterë personalë kanë raportuar lëndime në punë duke pretenduar kështu përfitime të konsiderueshme të kompensimit ndaj punëtorëve. Dokumentet e punës së një auditimi operacional për të përcaktuar shtrirjen e ekspozimit të kompanisë ndaj një detyrimi të lëndimit personal, duhet të përfshijnë:

- A. Analiza e kërkesave sipas llojit të pajisjeve dhe shtrirjes së përdorimit nga punonjësit individualë.
- B. Konfirmimet nga ofruesit e sigurimeve për kërkesat e paguara sipas politikave të kompensimit të punëtorëve në fuqi.
- C. Shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës të blerjes së kompjuterëve personalë.
- D. Listimi i të gjithë kompjuterëve personalë në përdorim dhe punonjësit që janë caktuar për t'i përdorur ato.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

22. Procesi i auditimit është të menduarit kritik, analizim dhe vlerësimi i kujdesshëm. Të gjitha procedurat mekanike janë të integruara në një kontekst më të gjerë të hetimit të kujdesshëm. Të gjitha auditimet përfshijnë një përshkrim dhe analizë të kontrolleve të brendshme. I audituari zgjidhet në një numër mënyrash - rreziku është baza primare për përzgjedhje. Departamentet që konsiderohen për auditim të mundshëm në vitin e ardhshëm dhe atributet e këtyre departamenteve janë të listuara më poshtë.

Departamentet	Prodhimi A	Prodhimi B	Prodhimi C	Blerjet	Marketingu	Shpërndarja	Sigurimi	Udhëtimi
Pasuritë	50,000 €	5,000,000€	1,000,000€	50,000 €	50,000€	60,000€	10,000€	6,000 €
Kostot vjetore	700,000 €	10,000,000€	1,000,000€	150,000€	500,000€	100,000€	100,000€	30,000 €
Probabiliteti i humbjes	10 %	1%	1%	10%	10 %	50%	90%	50%

Të gjitha këto departamente, përveç dy prej tyre, janë në listën e mundshme të të audituarit për shkak të një analize të rrezikut të kryer nga drejtori i auditimit. Departamenti i Prodhimit A është në listë sepse drejtori mendon se ka shumë pengesa (bllokime) që ndodhin në atë departament. Departamenti i marketingut është në listë sepse shefi i sigurimit mori një telefonatë anonime ku një menaxher marketingu u akuzua se kishte pranuar rryshfete financiare të konsiderueshme nga një media. Kontrollat e brendshme duken adekuate në të gjitha departamentet, me përjashtim në departamentin e marketingut.

Cili departament ka më shumë gjasa të ketë nevojë për një auditim të pastër operacional (jofinanciar)?

- A. Prodhimi A.
- B. Prodhimi B.
- C. Blerjet.
- D. Marketingu.

23. Qëllimi kryesor i takimit përmbyllës, është:

- A. Implementimi i gjetjeve të auditimit.
- B. Mbledhja e dëshmimeve të auditimit.
- C. Zgjidhja e çështjeve të mbetura.
- D. Përcaktimi i fushëveprimit të auditimit.

24. Auditori i brendshëm sapo ka përfunduar një pyetësor në vendin e ngjarjes me qëllim të njoftimit me operacionet e listave të pagave të kompanisë. Cila nga të mëposhtmet duhet të kryhet më tutje?

- A. Caktimi i personelit të auditimit.
- B. Vendosja e objektivave fillestare të auditimit.
- C. Shkruarja e programit të auditimit.
- D. Kryerja e punës në terren.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

25. Informacioni i mëposhtëm është në dispozicion nga pasqyrat financiare të një departamenti prodhimi. Drejtori i auditimit të brendshëm është duke shqyrtuar të dhënat për të identifikuar rreziqet potenciale si bazë për planifikimin e auditimit. Departamenti nuk është audituar nga departamenti i auditimit të brendshëm në tre vitet e fundit. Departamenti kryen shumicën e veprimtarisë së saj në mënyrë autonome. Departamenti është mbështetur historikisht në një produkt kryesor. Megjithatë, ky produkt po plakët dhe së shpejti do të humbasë mbrojtjen nga patenta.

Koeficienti	(20X3) Viti Aktual	(20X2) Viti paraprak	(20X1) Dy vite më parë	Mesatarja e industrisë
Koeficienti i qarkullimit	1.94	1.89	2.28	2.13
Koeficienti i shpejtë (testi acid)	0.66	0.88	1.22	1.4
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	112	93	72	69
Periudha e qarkullimit të stoqeve	148	167	92	73
KMSH si % e shitjeve	0.375	0.402	0.412	0.445
Shitjet / pasuritë e prekshme	2.89	2.58	2.53	3.01
Shitjet / pasuritë totale	1.33	1.31	2.53	2.78
Rritja e shitjeve	0.03	0.16	0.02	0.045
Fitmi neto ('000)	(7,600 €)	985 €	(1,200 €)	4,500 €

Cila nga të mëposhtmet nuk do të shpjegonte rënien e kostos së mallrave të shitura si përqindje e koeficientit të shitjeve? Departamenti:

- A. **Stoqet e likuiduara në raport me një plan për të sjellë koeficientin e qarkullimit më në linjë me mesataren e industrisë.**
- B. Rritja e çmimit të shitjes së produkteve të tij ndaj klientëve më pak të besueshëm.
- C. Regjistrimi i shitjeve të vitit të ardhshëm në vitin aktual, por rregullimi i stoqeve tek stoqet aktuale në dorë në fund të vitit.
- D. Është gabimisht duke kapitalizuar disa kosto prodhimi.

26. Një nga rolet kryesore të një programi të auditimit është:

- A. **Të shërbejë si një mjet për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e punës së auditimit.**
- B. Të dokumentojë të kuptuarit e auditorit në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm.
- C. Të sigurojë një qasje të standardizuar të angazhimit të auditimit.
- D. Të përshkruajë rrezikun e auditimit të pranuar nga auditori,

27. Supozoni se kompania juaj po konsideron blerjen e një kompanie të vogël të deponimit të mbeturinave toksike. Si auditorë të brendshëm, ju jeni pjesë e ekipit për kryerjen e rishikimit të kujdesit të duhur (due diligence) për blerjen. Fushëveprimi juaj (si auditorë) nuk ka gjasa të përfshijë:

- A. **Një vlerësim të vlerës së proceseve gjyqësore të paraqitura aktualisht kundër ndërmarrjes së mbeturinave.**
- B. Një rishikim të procedurave të kompanisë së blerë për pranimin e materialit të mbeturinave dhe krahasimin me kërkesat ligjore.
- C. Analizen e pajtueshmërisë së kompanisë me marrëveshjet e huasë dhe shpалosjen e tyre.
- D. Vlerësimin e efikasitetit dhe profitabilitetit të operacioneve të kompanisë së mbeturinave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

28. Një auditor i brendshëm është angazhuar për të kryer auditimin e programit të sigurimeve të kompanisë, duke përfshirë përshtatshmërinë e qasjes për të minimizuar rreziqet ndaj kompanisë. Kompania vetë-siguron humbjet e mëdha nga fatkeqësitë dhe u ofron të gjithë punonjësve të saj përfitime shëndetësore. Kompania është një firmë e madhe kombëtare me mbi 15,000 punonjës të vendosur në pjesë të ndryshme të vendit. Ajo përdor një procesor të jashtëm për të administruar programin e kujdesit shëndetësor. Shpenzimet mjekësore të kompanisë janë rritur me rreth 8% në vit për pesë vitet e fundit dhe menaxhmenti është i shqetësuar për kontrollin e tyre.

Cila nga procedurat e mëposhtme të rishikimit analitik do të ofronte më së shumti njohuri në arsyeshmërinë e rritjes së shpenzimeve të kujdesit shëndetësor?

- A. Zhvilloni një krahasim të kostove të shkaktuara me kostot e ngjashme të shkaktuara nga kompanitë e tjera.
- B. Merrni indeksin qeveritar të kostove të kujdesit shëndetësor për periudhën e krahasueshme kohore dhe krahasoni shkallën e rritjes me atë të kostos për një punonjës të shkaktuar nga kompania.
- C. Merrni një ofertë nga një administrator tjetër i kujdesit shëndetësor për të ofruar të njëjtat shërbime administrative si administratori aktual i kujdesit shëndetësor.
- D. Zhvilloni një krahasim të kostove të përgjithshme të sigurimit shëndetësor të shkaktuara nga kompania me kostot e ngjashme të shkaktuara nga kompanitë në të njëjtën industri.

29. Auditorët përdorin një shumëllojshmëri të metodave të indeksimit dhe referimit në dokumentet e punës së tyre të auditimit. Një menaxher i auditimit të brendshëm mund të krijojë një metodë të indeksimit të letrës së punës të përshtatuar për nevojat e një organizate specifike. Një agjenci qeveritare e auditimit do të krijonte një metodë për të gjitha organizatat nën juridiksionin e agjencisë. Cila nga të mëposhtmet më së miri shpjegon arsyen e këtij ndryshimi midis dy metodave të indeksimit të letrës së punës?

- A. Menaxheri i auditimit të brendshëm krijon një metodë që thjeshton procesin e rishikimit brenda një organizate të caktuar, por agjencia qeveritare e auditimit krijon një metodë uniforme për të thjeshtuar procesin e rishikimit të organizatave shumë të ndryshme që do të auditohen.
- B. Metoda e menaxherit të auditimit të brendshëm përcaktohet nga Standardet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA), por metoda e agjencisë qeveritare të auditimit kërkohet me politika të agjencisë.
- C. Metoda e menaxherit të auditimit të brendshëm përcaktohet nga Standardet e IIA, por me ligj kërkohet metoda e agjencisë qeveritare të auditimit.
- D. Menaxheri i auditimit të brendshëm krijon një metodë të përcaktuar nga komiteti i auditimit të organizatës, por agjencia qeveritare e auditimit krijon një metodë uniforme që kërkohet me ligj.

30. Departamenti i auditimit të brendshëm ka një projekt në proces për të përcaktuar nëse mund të kalojë në letrat e punës elektronike. Kriteret e vendimit do të bazohen kryesisht në kërkesat e standardeve të auditimit të brendshëm dhe në përvojën e departamenteve të tjera të auditimit.

Studimi i fizibilitetit duhet të njoh faktin që standardet e auditimit të brendshëm specifikojnë se për hartimin dhe përmbajtjen e dokumenteve të punës në formën elektronike:

- A. Konvertimi në letër duhet të bëhet jo më vonë se koha e shqyrtimit përfundimtar.
- B. Duhet t'i kushtohet vëmendje krijimit të kopjeve rezervë të dokumenteve të punës.
- C. Mjetet e komunikimit të përzgjedhura duhet të përcaktojnë hartimin dhe përmbajtjen e letrës së punës.
- D. Mbajtja e letrës së punës duhet të jetë vetëm një funksion i mjeteve të komunikimit të përdorura.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

31. Cila nga deklaratat në vijim transmeton informacionin negativ në mënyrë të tillë që një përgjigje e favorshme nga i auditori mund të arrihet ende?

- A. Kontabilisti juaj ka dështuar të harmonizojë deklaratën bankare çdo muaj.
- B. **Deklaratat bankare nuk janë harmonizuar çdo muaj.**
- C. Për fat të keq, kontabilisti juaj nuk ka gjetur kohë të harmonizoj deklaratën bankare çdo muaj.
- D. Ju me sa duket keni dështuar në informimin e kontabilistit tuaj se deklaratat bankare duhet të harmonizohen në baza mujore.

32. Një kompani prodhuese është duke u zgjeruar me shpejtësi dhe si rrjedhojë po konsideron shtimin e një linje të re prodhimi. Punonjësit aktualisht po punojnë me ndërrime (turne) të dyfishta dhe janë duke u paguar me shuma të mëdha të pagesës jashtë orarit. Aktualisht, kërkesa për të gjitha produktet e kompanisë është e lartë, por menaxhmenti është duke u shqetësuar për luhatjet e kërkesës me ndryshimet në ekonomi dhe zhvillimet teknologjike të konkurrentëve. Menaxhmenti është i shqetësuar me çështje të tilla si: nëse është duke përdorur burimet e saj në mënyrë efikase, nëse është duke u zgjeruar me shpejtësi ose jo me shpejtësi, nëse morali i punonjësve po bie dhe nëse zgjerimi i ardhshëm duhet të financohet me burime të brendshme ose nëpërmjet borxhit.

Nga kërkesat e mëposhtme të menaxhmentit drejtuar juve si auditor, cila nga të mëposhtmet është brenda fushëveprimit normal të auditimit, siç thuhet në standardet e IIA?

- A. **Kryeni një vlerësim të pavarur të procesit të planifikimit të menaxhmentit si bazë për të bërë rekomandime.**
- B. Bisedoni me bankat për të identifikuar alternativat e financimit dhe për të negociuar alternativat e kontratës, të cilat do t'i prezantohen menaxhmentit për vlerësim.
- C. Analizoni alternativat e financimit dhe paraqisni këto alternativa tek komiteti i auditimit.
- D. Kryeni analizën e vendimit për prodhim-ose-blejje për të përcaktuar nëse kompania duhet të nënkontrakttojë pjesët e prodhimit të saj kundrejt shtimit të kapacitetit. Raportoni rekomandimet tek menaxhmenti për miratim.

33. Departamenti i auditimit të brendshëm të një institucioni të madh financiar përfundoi një auditim të operacioneve tregtare të derivateve të kompanisë në degën e saj jashtë vendit. Raporti i auditimit ishte kritik sa i përket mungesës së kontroleve në procesin e tregtimit dhe mungesës së monitorimit efektiv të tregtarëve të suksesshëm nga zyrja vendore. Auditori dyshoi, por nuk e potencoi, se arsyeja që zyrja vendore i toleronte sjelljet e njësisë tregtare të degës së huaj ishte se dega dhe në veçanti një tregtar individual, kishte qenë shumë i suksesshëm. Suksesi krijoi fitime të mëdha dhe kështu ndikoi në shpërblimet e të gjithë anëtarëve të menaxhmentit të lartë. Pas pranimit të raportit të auditimit, menaxhmenti i lartë tregoi se ishte duke ndërmarrë veprime korrigjuese. Bazuar në veprimin e menjëhershëm korrigjues, auditori nuk ka raportuar gjetjen në komitetin e auditimit.

Cila nga deklaratat e mëposhtme, nëse është e vërtetë, mund të justifikonte vendimin e auditorit që të mos i raportojë shqetësimet e kontrollit komitetit të auditimit?

- A. Menaxhmenti planifikon të ndërmarrë veprime korrigjuese.
- B. Bordi i drejtorëve ka një komitet të veçantë për të bërë rekomandime për kompensimin.
- C. **Shumat e tregtimit dhe rreziqet potenciale që lidhen me degën e huaj nuk janë materiale krahasuar me organizatën në përgjithësi.**
- D. Derivatet janë komplekse dhe auditori duhet të mbështetet në analizën e menaxhmentit në lidhje me shkallën e problemit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

34. Raporti i auditimit në lidhje me një auditim të një banke kategorizon gjetjet në "gjetjet e mungesës" për probleme të mëdha dhe "fusha të tjera për përmirësim" për probleme më pak serioze. Cila nga fragmentet në vijim do të përfshihej në kategorinë "fusha të tjera për përmirësim"?
- A. Shumë kredi të siguruara nuk përmbanin mbulim të sigurimit të rrezikut për kolateralin e pasurive të prekshme.
 - B. Zyrtarët e kredive gjithashtu përgatisin çeqet e arkës për pagesën e kësteve të kredisë.
 - C. Banka është duke shkaktuar kosto të panevojshme të postës duke mos i kombinuar disa postime të posaçme për të kontrolluar klientët e llogarisë me postimet mujore të deklaratave të tyre.
 - D. Në një degë një sasi e madhe e parave të gatshme u vendos në një tavolinë lehtë të qasshme prapa linjave treguese.
35. Një anëtar i lartë i menaxhmentit, i cili është disa nivele më lart se udhëheqësi i fushës operationale që po auditohet, ka kërkuar një raport të gjetjeve të auditimit. Mjeti më i përshtatshëm i komunikimit të gjetjeve të auditimit me këtë anëtar të lartë të menaxhimit është:
- A. Dërgimi i një kopje të raportit përfundimtar të auditimit.
 - B. Komunikimi me gojë i gjetjeve.
 - C. Dërgimi i kopjeve të raporteve të ndërmjetme.
 - D. Dërgimi i seksionit përmbledhës të raportit.
36. Gjatë një auditimi të shpenzimeve të udhëtimit të përfaqësuesve të shitjeve, u zbulua se 152 prej 200 avanseve të udhëtimit të dhëna për përfaqësuesit e shitjeve, në vitin e kaluar, tejkaluan shumën maksimale të lejuar. Cila nga deklaratat e mëposhtme është një opinion i arsyeshëm i auditimit?
- A. Shumica e avanseve të udhëtimit në organizatë tejkalojnë maksimumin e lejuar.
 - B. Avanset e udhëtimit nuk kontrollohen në përputhje me politikën ekzistuese.
 - C. Avanset maksimale të lejuara të udhëtimit janë shumë të ulëta.
 - D. 76% e të gjitha avanseve të udhëtimit tejkalojnë maksimumin e përcaktuar nga menaxhmenti.
37. Mund të kërkohej punë pasuese (follow-up) për të siguruar që veprimet korrigjuese kanë ndodhur për gjetje të caktuara. Përgjegjësia e departamentit të auditimit të brendshëm për të kryer punën pasuese sipas nevojës duhet të përcaktohet në:
- A. Statutin e shkruar të departamentit të auditimit të brendshëm.
 - B. Deklaratën e misionit të komitetit të auditimit.
 - C. Memorandumin e angazhimit të lëshuar para çdo detyre të auditimit.
 - D. Deklaratën e qëllimit brenda raporteve të aplikueshme të auditimit.
38. Cili është mjeti i planifikimit të auditimit në përgjithësi dhe përdoret për të siguruar mbulim adekuat të auditimit me kalimin e kohës?
- A. Orari afat gjatë.
 - B. Programi i auditimit.
 - C. Buxheti i departamentit.
 - D. Statuti i departamentit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

39. Një auditor ka dorëzuar draftin e parë të raportit të auditimit tek i audituari në përgatitje për një intervistë dalëse. Më poshtë është një ekstrakt nga ky raport:

Auditimi u krye për të arritur disa objektiva.

Për të verifikuar ekzistencën e makinerisë së papërdorur që është duke u ruajtur në depo.

Për të përcaktuar nëse makineria është dëmtuar gjatë ruajtjes në depo.

Për të rishikuar procedurat e trajtimit që kryhen nga personeli i depos.

Për të përcaktuar nëse procedurat e duhura të kontabilitetit janë duke u ndjekur për makineritë që po mbahen në depo.

Për të kalkuluar vlerën e drejtë të tregut, aktuale, për stoqet e makinave në depo.

Për të krahasuar vlerën totale të makinerisë me regjistrimet kontabël të kompanisë.

Është konfirmuar se nga 30 makinat e përzgjedhura për mostrën nga regjistrat e blerjes, 13 ishin të pranishme në katin e depos dhe 5 të tjerat ishin në bankën e ngarkesës gati për t'u transportuar në fabrikën e prodhimit. Kohë më parë, dymbëdhjetë të tjerët ishin dërguar në fabrikën e prodhimit. Një ekzaminim i procedurave të kontabilitetit të përdorura për depo zbuloi dështimin nga nëpunësi i kontabilitetit të depos për të harmonizuar regjistrimet mujore të stoqeve të makinave, ashtu siç kërkohet nga politikat e kompanisë. Një mostër prej 25 makinash u ekzaminua për dëmet e mundshme dhe të gjitha, përveç njëres, ishin në gjendje të mirë. Është konfirmuar nga auditorët se procedurat e trajtimit të përshkruara në manualin e politikës së depos duket të jenë adekuate dhe se personeli i depos me sa duket po i ndjek këto procedura, me përjashtim të ekzaminimit të aartikujve që janë marrë për inventarizim.

Gjatë komunikimit me të audituarin, ekzistojnë në që të dyja, faktorët e situatës dhe karakteristikat e mesazhit që mund të dëmtojnë procesin e komunikimit. Auditori ka vetëm kontroll të kufizuar mbi faktorët e situatës, por ka kontroll të dukshëm mbi karakteristikat e mesazhit. Elementët e mëposhtëm zakonisht përfshihen në raportet përfundimtare të auditimit: qëllimi, fushëveprimi, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet. Cila nga të mëposhtmet përshkruan të gjitha elementet që mungojnë nga raporti i mësipërm?

- A. Fushëveprimi, konkluzionet, rekomandimet.
- B. Qëllimi, rezultatet, rekomandimet.
- C. Rezultatet, konkluzionet, rekomandimet.
- D. Qëllimi, fushëveprimi, rekomandimi.

40. Auditori i brendshëm raportoi një dyshim për mashtrim tek drejtori i auditimit të brendshëm. Drejtori ia ktheu të gjithë rastin në departamentin e sigurisë. Departamenti i sigurisë dështoi të hetojë ose të raportojë rastin tek menaxhmenti. Autori vazhdoi të mashtronte organizatën derisa u zbulua aksidentalisht nga një menaxher i linjës, dy vjet më vonë. Zgjidhni veprimin më të përshtatshëm për drejtorin e auditimit.

- A. Veprimet e drejtorit ishin të sakta.
- B. Drejtori duhet të kishte kontrolluar periodikisht statusin e rastit me departamentin e sigurisë.
- C. Drejtori duhet të kishte kryer hetimin.
- D. Drejtori duhet ta kishte shkarkuar kryerësin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

41. Një gjetje e auditimit është formuluar si në vijim:

Buxheti kapital përfshin fonde për blerjen e 11 automjeteve të reja. Shqyrtimi i të dhënave të përdorimit tregoi se: 10 automjete në flotën e 70 automjeteve janë ngasur më pak se 4,000 kilometra gjatë vitit të kaluar. Automjetet iu janë caktuar grupeve të ndryshme, normat e përdorimit të të cilëve kanë ndryshuar shumë. Nuk kishte asnjë politikë që kërkon rotacionin e automjeteve midis grupeve të përdorimit të lartë dhe të ulët. Mungesa e kriterëve për caktimin e automjeteve si dhe mungesa e një sistemi për monitorimin e përdorimit të tyre mund të çojë në blerjen e automjeteve të panevojshme.

Bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjetje, do të ishte e pështatshme që të rekomandojmë që menaxhementi duhet të:

- A. Vendosë një minimum prej 4,000 kilometrave për tremujor si kriter për caktimin e automjeteve tek grupet e përdoruesve.
- B. Krijoj një sistem për qarkullimin e automjeteve midis përdoruesve në mënyrë periodike.
- C. Vonoj blerjen e automjeteve të propozuara derisa kapaciteti i tepërt i dukshëm të shpjegohet ose zhvlerësohet në mënyrë adekuate.
- D. Ndaloj miratimin e buxhetit kapital derisa projektet e tjera të mund të rishikohen nga auditimi i brendshëm.

42. Arsyetimi më i mirë për rotacionin e auditorëve të brendshëm në mënyrë që individët e ndryshëm të caktohen në auditime të njëpasnjëshme tek një i audituar i caktuar, është:

- A. Parandalimi i ngarkesës nga ana e auditorit të brendshëm, e cila mund të çojë në qarkullim të tepërt në departamentin e auditimit të brendshëm.
- B. Promovimi i zhvillimit të shpejtë profesional nga ana e auditorëve të brendshëm duke i ekspozuar ata në gamën e plotë të aktiviteteve organizative.
- C. Rritja e kujdesit të ushtruar nga auditorët e brendshëm të cilët e dinë se cilësia e punës së tyre do të jetë e dukshme për grupin e ardhshëm të auditorëve të brendshëm.
- D. Shmangni zhvillimin e ndikimit nga një i audituar i caktuar.

43. Aftësitë individuale të anëtarëve të stafit janë veçori kyçe në efektivitetin e departamentit të auditimit të brendshëm. Zgjidhni konsideratën primare që përdoret kur punësohet personeli i departamentit të auditimit të brendshëm.

- A. Verifikimi i përvojës.
- B. Formulimi i duhur i detyrave të punës.
- C. Edukimi i vazhdueshëm.
- D. Orientimi organizativ.

44. Kritikat e fundit ndaj departamentit të auditimit të brendshëm sugjerojnë se mbulimi i auditimit nuk ishte duke ofruar reagime adekuate për menaxhmentin e lartë në proceset e përdorura në linjat kryesore organizative të biznesit. Problemi u definuar më tutje si mungesë e reagimeve mbi zbatimin e fundit të sistemeve të mbështetjes automatike. Cilat janë dy funksionet që udhëheqësi i auditimit të brendshëm duhet të përmirësojë?

- A. Personelin dhe komunikimin.
- B. Personelin dhe vendimmarrjen.
- C. Planifikimin dhe organizimin.
- D. Planifikimin dhe komunikimin.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

45. Për shkak të dobësive të kontrollit, është e mundur që menaxherët individualë të 122 restoranteve mund të kenë vendosur punonjës fiktivë në listën e pagave. Çdo restorant punëson 25-30 persona. Për të përcaktuar në mënyrë efikase nëse ky mashtrim ekziston në nivel më pak se 1%, auditori duhet të përdorë:
- A. Mostrimin sipas veçorive.
 - B. Mostrimin sipas gjykimit.
 - C. Mostrimin sipas drejtimit.
 - D. Mostrimin e zbulimit.
46. Cila nga të mëposhtmet është teknikë e mashtrimit me të dhëna?
- I. Ndryshimi i të dhënave para futjes në sistemin kompjuterik.
 - II. Ndryshimi i të dhënave gjatë futjes në sistemin kompjuterik.
 - III. Ndryshimi i të dhënave pas përpunimit nga sistemi kompjuterik.
 - IV. Të gjitha opsionet.
- A. I.
 - B. II.
 - C. III.
 - D. IV.
47. Cila nga teknikat e mëposhtme të sigurisë lejon kohë për përgjigje nga autoritetet hetuese?
- A. Pengimi.
 - B. Zbulimi.
 - C. Vonesa.
 - D. Refuzimi.
48. Qëllimi i cilit nga anëtarët e ekipit në vijim është i ngjashëm me atë të oficerëve të sigurisë së sistemeve të informacionit të përfshirë në një hetim të krimit kompjuterik?
- A. Hetuesi.
 - B. Avokati i qarkut.
 - C. Eksperti i kompjuterit.
 - D. Auditori i brendshëm i sistemeve.
49. Dëshmia më objektive dhe relevante në një mjedis kompjuterik që përfshin mashtrimin është:
- A. Ekzaminimi fizik.
 - B. Vëzhgimi fizik.
 - C. Hetimet e njerëzve.
 - D. Shkrimet kompjuterike.
50. Cila nga të mëposhtmet nuk është aktivitet kriminal në shumicën e juridiksioneve?
- A. Shkrimi i programit të virusit kompjuterik.
 - B. Përdorimi i programit të virusit kompjuterik.
 - C. Lëshimi i programit të virusit kompjuterik.
 - D. Shpërndarja e programit të virusit kompjuterik.